



Institut national de la statistique
et des études économiques
Mesurer pour comprendre



Mr. 1271/1 Prot

Dt. 04.07.2024

MEMORANDUM MIRËKUPITIMI

ndërmjet Institutit të Statistikave të Shqipërisë

dhe Institutit Kombëtar të Statistikave dhe Studimeve Ekonomike të Francës (INSEE)

INSTITUTI I STATISTIKAVE (INSTAT) të Shqipërisë dhe

INSTITUTIT KOMBËTAR TË STATISTIKAVE DHE STUDIMEVE EKONOMIKE TË FRANCËS (INSEE) të Francës

këtej e tutje referuar si "Palët"

bien dakord si vijon:

Neni 1

Objekti

Palët do të bashkëpunojnë për zhvillimin dhe rritjen e sistemit statistikor dhe modernizimin e infrastrukturës statistikore.

Neni 2

Të përgjithshme

1. Memorandumi përcakton një kornizë të përgjithshme dhe dispozita për bashkëpunim të frytshëm. Ai mbështet një sërë aktiviteteve dhe promovon përcaktimin e objektivave dhe procedurave të bashkëpunimit të ndërsjellë për shkëmbimin e informacionit, pikëpamjeve dhe përvojës me qëllim që të lehtësohen zhvillimet dhe zbatimi i aktiviteteve të përbashkëta statistikore.

2. Ky memorandum përfaqëson shprehjen e vullnetit të Palëve për të punuar së bashku në fushën e statistikave për të promovuar efikasitetin e njohurive dhe për të krijuar sisteme moderne për mbledhjen e të dhënave statistikore.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi përfshin synimin e Palëve të punojnë së bashku në të ardhmen në fushat statistikore të dakordësuara mes tyre.

2. Palët dakordësohen të bashkëpunojnë për aksesin dhe përdorimin nga INSTAT-i të instrumenteve innovative TI për mbledhjen e të dhënave, të zhvilluara nga INSEE.

3. Palët dakordësohen ta fillojnë këtë bashkëpunim në kuadër të Censit të radhës të Bujqësisë në Shqipëri në drejtim të:

- Trajnimit të stafit përkatës të INSTAT-it
- Transmetimit të njohurive për të zhvilluar autonominë e INSTAT-it

4. Ky bashkëpunim do të promovojë sjelljen profesionale në përputhje me Parimet Themelore të Statistikave Zyrtare të Kombeve të Bashkuara dhe Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane dhe do të sigurojë një forum për shkëmbimin e përvojës midis të dyja palëve.

Neni 4

Çështje të tjera kontraktuale dhe financiare

1. Në përputhje me dispozitat e këtij memorandumi, detyrat përkatëse për çdo veprimtari dhe asistencë e ekspertëve (si p.sh. numri i ekspertëve, programi i punës, kohëzgjatja dhe pagesa) do të përcaktohen paraprakisht nga Palët, sipas një forme në varësi të mënyrës së financimit të aktiviteteve.

2. Aktivitetet e përbashkëta duhet të jenë në përputhje me programet kombëtare përkatëse dhe mund të financohen nga buxheti kombëtar përkatës, buxheti institucional ose nga një prej projekteve të financuara nga BE apo nga mekanizma të tjerë të disponueshëm për zhvillimin e statistikave. Financimi i aktiviteteve do të përcaktohet në një marrëveshje të veçantë ndërmjet Palëve.

Neni 5

Administrimi

1. Përfaqësuesi i secilës Palë do të koordinojë aktivitetet e ndërmarra në këtë memorandum për të garantuar efektivitetin e bashkëpunimit.

2. Çdo Termë Reference e secilit aktivitet, pas dakordësimit nga Palët, do të bëhet pjesë e realizimit të këtij Memorandumi.

3. Për të ndjekur zbatimin e aktiviteteve sipas këtij Memorandumi, do të mbahen takime vjetore dhe raportet do të dërgohen secilës palë.

Neni 6

Pikat e kontaktit

Për INSEE	Për INSTAT
Patrick Hernandez	Maldi Dema
Division Appui technique international	Drejtoria e Koordinimit të SKS, Përafrimit dhe Projekteve
INSEE	INSTAT
Timbre L310	
88 avenue Verdier CS 70058 92541 Montrouge CEDEX	Rruga « Vllazen Huta », Nd. 35, H1, 1017, Tirana, Albania
E-mail : patrick.hernandez@inssee.fr	E-mail : mdema@instat.gov.al
Phone: +33 1 87 69 55 58	Phone: +355 6720 555 43

Neni 7

Çështje ligjore

1. Aktivitetet e bashkëpunimit të bazuara në këtë Memorandum nuk cenojnë legjislacionin kombëtar për sigurinë, konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe individuale të personave fizikë dhe juridikë.

2. Memorandumi nuk përbën një marrëveshje ndërkombëtare dhe për rrjedhojë nuk krijon të drejta dhe detyrime sipas legjislacionit ndërkombëtar.



Institut national de la statistique
et des études économiques

Mesurer pour comprendre



Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet apo dallimet në interpretimin apo zbatimin e Memorandumit, do të zgjidhen nëpërmjet konsultimit mes dy Palëve.

Neni 9

Hyrja në fuqi, përfundimi dhe ndryshimet

1. Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit, më 4 Korrik 2024, dhe përfundon në një periudhë të pacaktuar.
2. Çdo Palë mund të kërkojë jo më vonë se 90 ditë zgjidhjen e këtij Memorandumi nëpërmjet njoftimit me shkrim drejtuar palës tjetër.
3. Ky Memorandum mund të ndryshohet nëpërmjet miratimit me shkrim nga të dy Palët.

Nënshkruar në Paris, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët Shqip dhe Anglisht, ku tekset janë të vlefshme njëjloj. Në rastet e interpretimeve të ndryshme, prevalojnë kopjet në gjuhën angleze.

INSTITUTI I STATISTIKAVE TË SHQIPËRISË
(INSTAT)

Drejtor i Përgjithshëm

Elsa Dhuli

Paris, më 04.07.2024



INSTITUTI KOMBËTAR I STATISTIKAVE DHE
STUDIMEVE EKONOMIKE (INSEE)

Drejtor i Përgjithshëm

Jean-Luc Tavernier

Paris, më 04.07.2024

INSEE
Institut National de la
Statistique et des Etudes Economiques
88 Avenue Verdier
92541 Montrouge Cedex